



**Datë:** 23.03.2026

**Numër Protokolli:** 1451/2026

**A.nr.139/2026**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.139/2026, të datës 04.02.2026, të parashtruar nga ankuesja M.D, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 23.03.2026, mori këtë:

## V E N D I M

**Hedhet poshtë** si e palejuar ankesa A.nr.139/2026, e datës 04.02.2026 e parashtruar nga ankuesja M.D

## A r s y e t i m

Nëpunësja civile, M.D (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja*), më datë 04.02.2026 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 29.01.2026, të Komisionit Disiplinor të Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 06.02.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve, ndërsa ky i fundit më datë 03.03.2026, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kryetari i Këshillit, me datë 11.03.2026 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli: 1272/2026, përmes të cilit ankesës së ankueses nën shenjë A.nr.139/2026 të datës 04.02.2026 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 602/2026, të datës 04.02.2026, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Komisionit Disiplinor i datës 09.01.2026; Vendimin e Komisionit Disiplinor i datës 29.01.2026, Kopjen e ID-së së ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.02.2026; Përgjigjen në kërkesën e datës 03.03.2026; Kërkesën e L.K për Komisionin Disiplinor; Deklaratë e ankueses e datës 29.01.2026; Procesverbal i datës 20.01.2026; Kontratën e punës të datës 05.09.2025.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e palejuar**, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi i punësimit, pas përfundimit të procedurave të rekrutimit, sipas Rregullores (KQZ) NR.02/2024 për Pranimin e Personelit të Përkohshëm në KQZ, me datë 05.09.2025, ka lidhur kontratën e punës me ankuesen, në periudhë të caktuar kohore, për pozitën Zyrtar i Shërbimit për Votues në Komisionin Qendrorë të Zgjedhjeve, me kohëzgjatje nga data 08.09.2025 deri më 31.10.2025, me mundësi vazhdimi pas vlerësimit të nevojave të institucionit, më së shumti 3 vite.

Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses, respektivisht U.D Udhëheqësi i Divizionit për Shërbim të Votuesve, duke iu referuar Vendimit të Këshillit A.nr.1738/2025 i është drejtuar me datë 11.12.2025 Komisionit Disiplinor me kërkesën që të trajtojnë rastet e shkeljeve të ankueses, me arsyetimin se e njëjta është vonuar dhe nuk ka respektuar orarin e punës, mosgatishmëria për kryerjen e detyrave të punës dhe mosrespektimi i udhëzimeve të marra nga udhëheqësi sikurse edhe sjellja jo e mirë me kolegët e punës.

Komisioni Disiplinor, fillimisht përmes Vendimit të datë 09.01.2026 ia ka shtyrë afatin procedurës së vendimmarrjes edhe për 30 ditë , lidhur me shqyrtimin e kërkesës së udhëheqësit të ankueses të datës 11.12.2025, ndërsa përmes Vendimit të datës 29.01.2026 Komisioni Disiplinor i KQZ-së, lëndën e ka bartë te Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses, respektivisht U.D Udhëheqësi i Divizionit për Shërbim të Votuesve, me qëllim që ky i fundit duhet të nxjerrë akt administrativ lidhur me vlerësimin e përvojës së punës provuese, pasi që veprimet për të cilat udhëheqësi ka pretenduar se janë shkelje disiplinore, kanë të bëjnë me periudhën e punës provuese të ankueses, ndërsa Komisioni Disiplinor këtë arsyetim e mbështetet edhe në vendimin e Këshillit A.nr.1738/2025 të datës 26.11.2025.

Ankuesja në ankesën e parashtruara në Këshilli, kundër Vendimit të datës 29.01.2026 të Komisionit Disiplinor të KQZ-së, pretendon se Komisioni Disiplinor dhe udhëheqësi i saj nuk kanë prezantuar asnjë provë rreth shkeljeve të pretenduara me arsyetimin se është larguar nga puna në mënyrë kundërligjore.

Kolegji i Këshillit para se të lëshohet në pranueshmërinë ankeses apo shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, fillimisht analizoi aktin e kontestuar, gjegjësisht Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 29.01.2026 dhe konstatoi se, përmes pikës I të dispozitivit të aktit të kontestuar përcaktohet apo është vendosur si në **vijim**: *“Komisioni Disiplinor i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vendos për të kthyer rastin te mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, U.D Udhëheqësi i Divizionit për Shërbim të Votuesve, z. L K, i cili obligohet që brenda pesë ditëve të punës, të nxjerrë akt administrativ për vlerësimin e periudhës provuese në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi”*.

Thënë si më lartë, me qëllim të shqyrtimit dhe konstatimit të pranueshmërinë së ankesës së ankueses, Kolegji i Këshillit mori përbazë dispozitat e aplikuara nga neni 129 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme ku përcaktohet se: *“Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.1. nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; 1.2. ankuesi ka legjitimitet në përputhje me nenin 124 të këtij Ligji; 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji, dhe 1.4. çfarëdo kushte të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj.”*, ndërlidhur me paragrafin 3 të nenit 27 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil”* dhe konstatoi se ankesa e ankueses e datës 04.02.2026 e parashtruar në Këshill kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 29.01.2026, është e palejuar, pasi që në rrethanat e rastit konkret Komisioni Disiplinor nuk ka cenuar asnjë të drejtë nga marrëdhënia e punës ngase nuk ka vendosur meritorisht, gjegjësisht akti në fjalë në këtë rast ka qenë i ndërmjetëm apo procedural pasi që lënda është bartë te udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë për vendimmarrje.

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se ankuesja po ashtu në Këshill me datë 06.02.2026 ka parashtruar ankesë të regjistruar nën shenjën A.nr.148/2026 kundër Vendimit të datës 05.02.2026 të nxjerrë nga Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve, përmes të cilit akt ankueses i është ndërprerë marrëdhënia e punës, prandaj në këtë rast Këshilli është në proces të shqyrtimit të lëndës si lëndë e veçantë për të cilën do të vendos meritorisht në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuara të ligjit material dhe kuadrit ligjor në fuqi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi, ashtu që ankesën e ankueses të datës 04.02.2026 e hedhi poshtë si të palejuar, për arsyet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda:A.nr.139/2026, datë 23/03/2026**

**Avdyl BEKTESHI**

**Arben MEHMETI**

\_\_\_\_\_  
**Procesmbajtës**

\_\_\_\_\_  
**Kryetar i Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses M.D;
- Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.